



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0898

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Isa Hasani - Anëtar dhe Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Botek” shpk, kundër Vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit të “Ministria e Shëndetësisë” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “RITENDER - Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemit BHIS” me numër të prokurimit 206-23-571-2-1-1, me 18/01/2024, mori:

Vendim

1.Aprovohet si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik, “Botek” shpk e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 13.11.2023 me numër protokollit 898/2023 për aktivitetin e prokurimit kundër, vendimi për anulim lidhur me aktivitetin e prokurimit: “RITENDER - Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemit BHIS” me nr. të prokurimit: 206-23-571-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues- “Ministria e Shëndetësisë”, mbetet në fuqi vendimi i AK për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

3.Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues aprovohet pjesërisht, të njëjtit i kthehet tarifa e paguar me parashtrimin e ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 03.02.2023, “Ministria e Shëndetësisë” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: “RITENDER - Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemit BHIS” me nr. të prokurimit: 206-23-571-2-1-1. Ndërkaq me datën 25.10.2023 është publikuar njoftimi mbi vendimin e AK me të cilin ka anuluar aktivitetin e

prokurimit.

(OE) “Botek” shpk me datën 30.10.2023 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK.

Me datën 02.11.2023, AK- “Ministria e Shëndetësisë” me vendim ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të OE- “Botek” shpk lidhur me aktivitetin e prokurimit “RITENDER - Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemit BHIS” me numër të prokurimi206-23-571-2-1-1 të inicuar nga. AK- “Ministria e Shëndetësisë” me këtë vendim AK ka kërkuar të Refuzohet si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues “Botek” shpk me datën 13.11.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 898/23, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontratës: shërbime, vlera e parashikuar e kontratës: **1,080.000.00 €**.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Botek” shpk janë parashtruar si në vijim:

Kërkesa 1: “Operatori Ekonomik duhet të ketë përvojë në zhvillimin dhe implementimin e të paktën 1 (një) projekti për Health Information System, për të paktën njërin nga nivelet e shëndetësisë”- E ka ofruar listën e kontratave, por asnjëra nga referencat NUK e përmbush kërkesën për (një) projekti për Health Information System, për të paktën njërin nga nivelet e shëndetësisë (Parësor, Sekondar ose Terciar). Referenca e MSH-Banka Botërore për projektin “System platform for HIS information System” ka të bëjë

me Sistemin e Fondit të Sigurimeve Shëndetësore dhe nuk ka fare të bëjë me Health Information System.
”

Në arsyetimin e eliminimit tonë, nuk japin asnjë shpjegim se vërtet çka përmban ky projekt, mirëpo deklarojnë duke mashtruar/devijuar qëllimisht: System platformë for HIS information System” ka te beje me Sistemin e Fondit të Sigurimeve Shëndetësore dhe nuk ka fare te beje me Health Information System. D.m.th. projekti HIFIS ka te beje me menaxhimin e proceseve për rimbursimet buxhetore dhe proceseve te brendshme te Fondit të Sigurimeve, ndërsa referenca e kërkuara nga MSH për HIS i dedikohet pjesës shëndetësore. Përveç shpjegimeve të tyre të pabazuara, ata i referohen mendimit të një personi, për ne i panjohur mbi autorizimet dhe kompetencat që ai ka në këtë proces, z. Ozren Pezo, konstatojmë se opiniononi i dhënë nga ana e tij përmban gjithashtu vlerësime të pabazuara, njëanshme dhe tendencioze. Kjo tregon më së miri tendencën e AK-së, nga fillimi i vlerësimit të këtij projekti, por duke vazhduar edhe me marrjen e opinionëve të njëanshme dhe tendencioze, që me të gjitha mjetet të ndryshojnë faktin se referenca HIFIS është një referencë në tërësinë e saj e plotëson kushtin sipas dosjes së tenderit. Sistemi HIFIS, për çka kemi ofruar si referencë nuk është i njëjtë 100% me sistemin HIS dhe do të ishte absurde të kërkohej dhe pretendohet që sistemet duhet të jenë të njëjta, çka ne nuk e kemi pretenduar në asnjë fazë, mirëpo ky sistem, sikurse e kemi faktuar gjithmonë në të gjitha fazat e këtij tenderi, dhe që na është ri konfirmuar edhe nga ana e ekspertëve të OSHP-së, ka lidhshmëri të ngushtë dhe të pashkëputshme me sistemin HIS dhe që të dy sistemet janë pjesë përbërëse e sistemit informativ të shërbimeve shëndetësore në Kosovë.

Pra, HIFIS nuk funksionon i pavarur nga sistemi HIS, sikurse dhe HIS nuk është i plotë dhe funksional pa ndërlihdjen me HIFIS. Kjo ndërlihdje e ngushtë dhe varshmëri e këtyre dy sistemeve, është përshkruar me saktësi në raportin e ekspertit teknik (datë 12.07.2023, nr. i lëndës 2023/0282), i cili i ka marr për bazë dokumentet e dorëzuara nga ne dhe ka përshkruar me saktësi të plotë se çka vërtet përmban sistemi HIFIS -referenca jonë, dhe konstatohet nder lidhshmëria e shumëfishtë e tij me HIS. Cit nga ekspertiza: “Në këtë kontekst, OE ankuese, Botek, ka prezantuar HIFIS (Sistemi Informativ për Sigurimet Shëndetësore), i cili sipas mendimit tonë, këto dy sisteme HIFIS, megjithëse këto dy sisteme HIS dhe HIFIS janë të ndërlihdura në mënyrë të ngushtë në mes veti, shërbejnë për qëllime të ndryshme në industrinë shëndetësore, e në këtë rast janë implementuar në të njëjtin entitet, në këtë rast, Ministrinë e Shëndetësisë, në periudha të afërta kohore. HIFIS është specifik për organizatat e sigurimeve shëndetësore dhe merret me menaxhimin e informacionit dhe proceseve të lidhura me sigurimet.

Pra, këto çështje lidhen ngushtë me buxhetin, statusin e pacientit, rimbursimin buxhetor që lidhet ngushtë me kostot e vizitave, si ambulatore ashtu edhe spitalore, listën e shërbimeve të kryera dhe kostot e tyre, si dhe validimin e tyre nëpërmjet proceseve të marrë nga sistemi HIS. Ndërsa HIS është një term më i gjerë që përfshin sisteme të ndryshme informacioni të përdorura brenda organizatave të kujdesit shëndetësor për të mbështetur kujdesin ndaj pacientit, operacionet klinike dhe menaxhimin e informacionit shëndetësor. Ai bazohet në protokollet dhe procedurat shëndetësore si ICD10 dhe ICD9 në kuadër të një cikli brenda të njëjtit nivel ose ndërmjet niveleve të ndryshme shëndetësore, në rastin tonë nga Qendra e Mjekësisë Familjare deri te klinikat e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK).

Prova 1_Raporti i ekspertit_2023-0282

Për më tepër, platforma HIFIS e realizuar nga ne, me sukses të plotë, konfirmuar edhe me referencë, është projekt me kompleksitet të lartë, i zhvilluar përgjatë disa viteve, ka vlerë dhe volum dy herë më të lartë se sa sistemi ekzistues HIS, i cili (sistemi HIS), sikurse kemi deklaruar edhe në ankesë, në masë të

konsiderueshme nuk ka qenë funksional dhe në shfrytëzim nga institucionet shëndetësore. Implementimi dhe zhvillimi i sistemit HIFIS ka përfshirë të gjitha nivelet e shëndetësisë në sektorin publik dhe privat. HIFIS është pjesë shumë e rëndësishme përbërëse e sistemit informativ shëndetësor të Republikës së Kosovës, është sistem që ndërlidhet dhe shfrytëzohet nga të gjitha institucionet shëndetësore të të gjitha niveleve në Kosovë. Sikurse e kemi shpjeguar dhe në ankesën e mëparshme, si dhe në Kërkesën për Rishqyrtim, më poshtë gjëni sqarimin tonë shtesë, i cili mbështet pretendimin tonë se sistemi HIFIS ka lidhshmëri me HIS, dhe si e tillë duhet të pranohet referenca jonë:

Përmes sistemit HIFIS plotësohet kushti që i referohet një sistemi të dizajnuar për të menaxhuar me të dhënat shëndetësore, duke përfshirë mbledhjen, ruajtjen, përpunimin, menaxhimin, transmetimin dhe raportimin e të dhënave të nevojshme për përmirësimin e efikasitetit të shërbimit shëndetësor, duke ofruar dosje dixhitale për të gjithë pacientët pavarësisht nivelit të shërbimit shëndetësor të ofruar. Për më tepër, Sistemi HIFIS është sistem shumë dimenzional, i cili përveç pjesës së administrimit dhe menaxhimit me pjesën financiare është ngushtë i lidhur me sistemin shëndetësor, duke ofruar shërbime të ndryshme për të gjitha nivelet e shërbimit shëndetësorë, prandaj edhe është pjesë e projektit të shëndetësisë kosovare dhe nuk mund të konsiderohet për interesa të caktuara se nuk është pjesë e shëndetësisë kosovare. Në vijim po i paraqesim vetëm tri pika përmes të cilave sistemi HIFIS është i ndërlidhur ngushtë me sistemin shëndetësorë në të gjitha nivelet:

- Përmes ofrimit të shërbimit të statusit të pacientit - shërbim i cili përfshin hapin e parë në sistemin shëndetësor, pa këtë sistem nuk ka kuptim në ofrimin e shërbimit në të gjitha nivelet e sistemit shëndetësor. - Përmes e-Recetës - e cila përmban informacionet që përshkruhen nga mjekët në të gjitha nivelet shëndetësore për pacientët që paraqiten. Brenda sistemit HIFIS është sistemi eRecetë i cili është i sinkronizuar me Farmacitë (Sistemi për Menaxhimin e Stokut Farmaceutik – SMSF) dhe Qendrën Mjekësore – Staf Mjekësor (Sistemi për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore HRSMSH). - Përmes validimit të shërbimeve që ofrohen nga Institucionet Shëndetësore - Ndërlidhja me të gjitha nivelet e sistemit për të ofruar shërbimet shëndetësore dhe validimin e të gjitha shërbimeve shëndetësore duke filluar nga Institucionet shëndetësore, stafi shëndetësor, shërbimet e standardeve ICD 10, etj.

Në dokumentin që e kemi prezantuar si provë (Prova 2_HIFIS System Connections) prezantohen përmbajtja dhe qëllimi i projekti HIFIS, të cilat dëshmojnë që ky projekt ka lidhshmëri të ngushtë edhe me HIS dhe si e tillë është një referencë e vlefshme.

(Prova 2_Dokumenti “HIFIS System Connections”)

Po ashtu, si provë bashkëngjisim edhe specifikimet e detyrueshme teknike, nga dosja e tenderit të platformës së implementuar

(Prova 3_Technical specification_HIFIS)

Bazuar dhe në veprimet e mëhershme të AK në këtë procedurë, ne vlerësojmë se AK nuk ka menaxhuar mire me këtë aktivitet të prokurimit, duke bërë shkelje të një pas njëshme të LPP dhe rregulloreve në fuqi, duke filluar që nga tendenca e tyre që këtë projekt të ia përshtat në të gjitha aspektet, OE që kishte propozuar fillimisht për kontratë, ku përmes sqarimeve shtesë, ka aprovuar kërkesën që në vend të referencës, OE mund të dorëzojnë kontrata dhe fatura të lëshuara për projekt, si dëshmi për përfundim të suksesshëm të projektit.

2. Pretendimi i dytë i Autoriteti Kontraktues Pretendimi i AK:

AK-gëzon të drejtën të kërkoj nga OE në afatin përcaktuar në këtë dokument që të krijoj edhe modulet dhe shërbimet shtesë pa asnjë kufizim në kosto, apo afat kohor- Referuar Ofertës së OE-së nuk ofrohet kjo mundësi, OE në fjalë gjatë gjithë kohës ndërlihet që do të krijoj sistem të ri, gjë që është në kundërshtim me kërkesën e AK-së dhe nuk mund të pranohet si zgjidhje. Në ofertë është specifikuar që AK e gëzon të drejtën të kërkoj nga OE në afatin e përcaktuar që të krijojnë edhe modulet dhe shërbimet shtesë pa asnjë kufizim në kosto, apo afat kohor. Prioritet 4 – “zhvillimi i moduleve të reja jo me vonë se 20 dite pune. - Sipas Ofertës tuaj ju keni ofruar zhvillim vetëm vitin e parë, gjë që është në kundërshtim me kërkesën e AK-së, sipas DT kërkohet që bëhet Zhvillim gjatë gjithë kohës sipas kërkesës së AK-së.

Referuar Kërkesës së AK se kërkohet Avancim dhe mirëmbajtje e sistemit ekzistues pa ndryshuar natyrën dhe metodologjinë gjë që kjo oferte rezulton me ndryshim nga Objektivi i projektit, ndërsa referuar ofertës tuaj rezulton se keni ofruar që sistemi të zhvillohet nga Fillimi gjë që është në kundërshtim të plotë me kërkesën e AK-së pasi modulet ekzistuese vetëm janë në përdorim dhe nga të njëjtët ofrohen shërbime pa ndërprerë, andaj nga MSh nuk është kërkuar që të ndryshoi sistemi, kjo është e Specifikuar edhe tek qëllimi i projektit "Mirëmbajta dhe Avancim e zgjidhjes ekzistuese". Referuar Ofertës Teknike ndër të tjera keni deklaruar se do të ofroni një sistem softuerik... gjë që është në kundërshtim të plotë me kërkesat e AK-së dhe dëshmon qartë se OE nuk ka ofertuar për Mirëmbajtjen dhe Avancimin e këtij sistemi mirëpo me qëllimin e krijimit të një Sistemi të Ri, kjo gjë me detaj është e qartësuar në faqe 48 tek Propozimi Teknik i ofertës së OE. Referuar ofertës suaj përkatësisht faqe 62 dhe 63 vërehet qartë se ju nuk do të avancojë sistemin siç është përshkruar në dosje të tenderit, pasi referuar Planit dinamik në faqe 63, ku potencohet se do të ofroj mirëmbajtje 36 muaj dhe nuk do të ofroj avancim në zgjidhjen ekzistuese, andaj plani dinamik i propozuar dëshmon një gjë të tillë”.

Përgjigja jonë:

Edhe ky pohim i AK-së nuk qëndron. Në nuk kemi dhënë zgjidhje për zhvillim vetëm për 20 ditë pune dhe as nuk kemi ofertuar për krijimin e një sistemi të ri. Në kemi dhënë ofertën për zhvillime, avancime dhe mirëmbajtje të sistemit ekzistues për 36 muaj sipas kërkesave në dosjen e tenderit. Sa i përket pretendimit të AK-së se në kemi deklaruar se ofrojmë sistem softuerik, “... tjera keni deklaruar se do të ofroni një sistem softuerik...” në bazë edhe të cilit pretendim kanë ardhur në përfundim se në do të ofrojmë sistem të ri, nga faqja 48 e zgjidhjes të teknike. Ky pretendim i AK-së është i pavërtetë dhe tendencioz dhe AK tenton që të devijoj atë se çfarë në kemi deklaruar në zgjidhjen të teknike. Në në faqen 48 të dokumentit 7. Propozimi Teknik dhe Plani i mirëmbajtjes BHIS, flasim për Mirëmbajtjen dhe procesin e mirëmbajtjes, dhe jo për zhvillimin e një sistemit të ri.

Cit:

Kërkesa nga AK në dosjen e tenderit: Gjatë kësaj periudhe, Kontraktuesi do të identifikoj dhe zgjidhë problemet për të siguruar funksionimin adekuat të sistemit. Kontraktuesi duhet të ofroj një sistem softuerik, efektiv për lajmërimin dhe monitorimin e zgjidhjes së problemeve eventuale. Oferta jonë: Gjatë kësaj periudhe, Grupi i Operatorëve Ekonomik deklaroi se do të identifikoj dhe do të zgjidhë problemet për të siguruar funksionimin adekuat të sistemit. Grupi i Operatorëve Ekonomik do të ofroj një sistem softuerik, efektiv për lajmërimin dhe monitorimin e zgjidhjes së problemeve eventuale.

Kërkesa nga AK në dosjen e tenderit: Menaxhimi i ndryshimit (faza e avancimit të sistemit gjatë mirëmbajtjes): OE është i obliguar që të avancojë sistemin (BSISH sistemin ekzistues si dhe nën-sistemet e reja), gjatë periudhës së mirëmbajtjes pa pagesë shtesë. Oferta jonë: Menaxhimi i ndryshimit (faza e

avancimit të sistemit gjatë mirëmbajtjes): Grupi i Operatorëve Ekonomik do të avancojë sistemin (BSISH sistemin ekzistues si dhe nën-sistemet e reja), gjatë periudhës së mirëmbajtjes pa pagesë shtesë.

Prova 4_Propozimi teknik

Pra në mënyrë që të ofrojmë mirëmbajtje me efektive për lajmërimin dhe monitorimin e zgjidhjes së problemeve eventuale, ashtu siç është kërkuar nga AK në dosjen e tenderit faqe 24 e dosjes së tenderit, ne do të kemi një sistem softuerik për Mirëmbajtje, dhe kjo nuk ka të bëjë fare me vet Aplikacionin e BHIS. Në ofertën tonë teknike kemi paraqitur planin dinamik i cili është një paraqitje vizuale se si ne propozojmë realizimin e të gjitha pikave paralel, por duke mos kufizuar/përjashtuar asgjë nga kërkesat e AK në Dosjen e Tenderit, apo edhe gjatë procesit të implementimit, sikurse edhe kemi konfirmuar edhe në deklaratat tjera nga ana jonë.

Pra ka qenë një virtualizim i mundshëm dhe jashtë çdo kërkesë nga AK, pra ka qenë draft propozim nga ana jonë, por kurrësi përfundimtare, pasi që i njëjti do të mund të qartësohet/shpjegojë qoftë gjatë fazës së vlerësimit. Dhe i njëjti gjithësi do të mund të ndryshohet sipas dinamikës dhe kërkesave që do të parashtraheshin nga vet AK, në planin e ri menaxhimit. Ne për të gjitha kërkesat teknike në dosjen e tenderit, kemi deklaruar se të njëjtat i kemi kuptuar saktë dhe do të iu përmbahemi pa asnjë përjashtim, sikurse mund të konfirmohet edhe në provën 4_Propozimi teknik. Përveç tjerash, ky dokument nuk ndërlidhet fare me pretendimin e AK, në vendimin e tyre për eliminim, pasi që nëse i referohemi Propozimit teknik të dorëzuar me ofertën tonë, në faqe 52, ne kemi deklaruar shprehimisht në lidhje me 15. Koha e Intervenimit ne kërkesa

Prioriteti 4- zhvillimi i moduleve te reja jo me vonë se 20 ditë pune. Pra, oferta jonë teknike, është në përputhje të plotë me kërkesat e AK-së në DT, ndërsa Plani dinamik është keqkuptuar/keqinterpretuar qëllimisht nga AK, çka ka vënë në lajthitje edhe ekspertin shqyrtues/teknik. Ky keqinterpretim i qëllimshëm dhe deklarim i pabazuar nga AK, duke shfaqur të kundërtën e asaj që ne kemi deklaruar në të gjitha deklaratat tona dhe në ofertën teknike. Prandaj, me veprimet e tyre të kundërligjshme, AK ka bërë shkelje flagrante të LPP dhe akteve nënligjore në fuqi, dhe atë: Neni 6: Ekonomiciteti dhe Efikasiteti Neni 59 i LPP Nr. 04/L-042 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve AK ka shkelur këtë nen të LPP-së pasi që nuk ka vlerësuar qartë dhe drejtë ofertën tonë. Për më tepër, ky nen i lejon AK-së: Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve.

Pra, në mënyrë që të bëjë vlerësimin më të saktë të ofertës, pas parasysh që oferta e konzorciumit tonë është me çmimin 100% më të lirë se oferta e OE të propozuar për kontratë, AK nuk ka marrë parasysh fare këtë dispozitë të LPP-së dhe pa u mbështetur në asnjë provë relevante, na shpallë të eliminuar. Bazuar në të gjitha sqarimet e mësipërme, provat e prezantuara dhe në veprimet/mos veprimet e AK-së, vijmë në përfundim se AK ka planifikuar në çdo formë këtë aktivitet të prokurimit, ka bërë shkelje të LPP-së duke ia përshtatur OE të caktuar, me ofertën më të lartë. Ndërsa kur tentativa për të shpallur fitues atë OE dështoi, AK anulon të gjithë procedurën, pavarësisht se ka një ofertë të përgjegjshme.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “Botek” shpk konsideron se Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 6, 7, 28, dhe 59 të LPP-së . duke propozuar **të anuloj Njoftimin mbi vendimin e AK të datës: 25.10.20232. të kthej lëndën në rivlerësim, ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve - Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës - Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit - Neni 72**

Dokumentacioni dhe informacioni shtesë.

Përgjigja e AK-së ndaj kërkesës për rishqyrtim. Përgjigje e Autoritetet Kontraktues ne lidhje me pretendimin Ankimore.

Ne lidhje me pretendimin e pare rreth mendimit të dhënë nga eksperti z. Ozren Pezo, ju njoftojmë se bazuar ne Vendimin e OSHP-se nr. 282/23 te datës 13.09.2023, ne paragrafin e trete faqe 11 është potencuar si ne vijim.

Lidhur me dy çështjet e ngritura si me sipër, paneli shqyrtues ka arritur në konstatimin se nuk ka qene e mundur deri tek arritja e vendosjes përfundimtare për faktin se përveç mangësisë argumentuese nga ana e AK-se lidhur me eliminimin e OE ankues mbi këto pika, po ashtu duke u nisur pesha e argumenteve, sqarimeve dhe fakteve të paraqitura nga palët janë konsideruar si te mangëta e po ashtu me përmbajtje kundërthënëse ne parim, andaj PSH konstaton se gjate procedurës së rivlerësimit lidhur me këto pika obligohet AK që të vërtetojë edhe njëherë ne mënyre me te detajuar dhe te arsyetuar, qofte edhe nga një pale e trete, në aspektinteknik se a përmbushen këto kriteret nga ana e OE ankues plotësisht, kështu duke qartësuar situatën ne aspektin teknik ne mënyre që të arrihet ne një konkludim të qartë të mbështetur neanaliza profesionale.Bazuar ne këtë konstatim te PSH te OSHP-se, MSh ka kërkuar ekspertize nga z. Ozren Pezo dhe kemi marre sqarimet e prezantuara ne Raportin e Vlerësimit dhe Letrën standarde për tenderuesin e eliminuar te dt. 25.10.2023.Duke marre parasysh se ne Njoftimin për Kontrate dhe ne Dosje te Tenderit, te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, është kërkuarKërkesa 1. "Operatori Ekonomik duhet të ketë përvojë ne zhvillimin dhe implementimin e të paktën 1 (një) projekti për Health Information System, për te paktën njërin nga nivelet e shëndetësisë.

Gjate rivlerësimit kemi kërkuar opinion ligjor le Departamenti Ligjor MSh-se dhe prei tyre kemipranuar përgjigjen me shkrim me nr. protokollit 05-6593/2 të datës 24.10.2023, ku është sqaruar sekërkuar ne kriterin e NJK dhe DT.Fondi Sigurimeve Shëndetësorë nuk i takon ndonjërit nga nivelet e shëndetësisë, siç ështëPërgjigja me shkrim nga Departamenti Ligjor i MSh-se është si ne vijim:Ne lidhje me kërkesën tuaj të datës 18.10.2023 nr.prot-6593, bazuar ne Ligjin Nr. 04/1-125 përshëndetësi llojet e institucioneve shëndetësorë parashihen ne nenin 17. Sipas neni 17 paragrafi I janësektorin: publik, privat, dhe publiko-privat.përcaktuar llojet e institucioneve ne sistemin shëndetësor të Republikës se Kosovës janë të njëjta nëParagrafi 2 i nenit 17 parashih Institucionet e nivelit parësor të kujdesit shëndetësor e qe janë:

1. Qendra kryesore e mjekësisë familjare me njësitë përbërëse të përcaktuara me aktin nënligjor tënxjerre nga Ministria;

Ne paragrafin 2 numërohen Institucionet e nivelit dytësor të kujdesit shëndetësor të cilat janë:

1. Spitali i përgjithshëm dhe special me njësitë përbërëse të përcaktuara me aktin nën-ligjor tënxjerre nga Ministria;

1. Poliklinika specialitike;
2. Ambulanca specialitike
3. Ambulanca stomatologjike
4. Qendra e shëndetit mendor me Shtëpinë për integrim ne bashkësi;
5. Qendra e transfuzionit të gjakut;

6. Qendra e rehabilitimit fizikal dhe klimatik
7. Qendra e mjekësisë sportive
8. Qendra e mjekësisë së punës.
9. Qendrat rajonale të shëndetësisë publike.
10. Qendra për rehabilitimin e të dëgjuarit dhe të folurit.

Kurse Institucionet e niveli tërësor të kujdesit shëndetësor janë:

1. Qendra klinike universitare;
2. Qendra klinike universitare stomatologjike;
3. Instituti kombëtar i shëndetësisë publike;
4. Qendra kombëtare e mjekësisë së punës;
5. Qendra kombëtare e mjekësisë Sportive;
6. Qendra kombëtare e transfuzionit të gjakut;
7. Qendra kombëtare e telemjekësisë.

Gjithashtu Barnatoret janë institucione shëndetësore që funksionojnë në të tri (3) nivelet e kujdesitshëndetësor.

Ligji Nr. 04/L-125 për shëndetësinë e përkufizon Fondin e Sigurimit Shëndetësor si institucion i sigurimit publik shëndetësor me cilësi të personit juridik që ka të drejta, obligime, përgjegjësi dhe autorizime të përcaktuara me ligji të veçantë.

Po ashtu, sipas Ligjit Nr. 04/1-249 për sigurimin shëndetësor, Fondi i Sigurimeve Shëndetësore është institucionin publik i sigurimit shëndetësor me statusin e personit juridik me të drejta, obligime, përgjegjësi dhe autorizime të veçanta për zbatim të këtij ligji në emër të siguruarve përfshirë mbledhjen efektive të mijtëve financiare për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor ngainstitucionet shëndetësore në të gjitha format e pronësisë.

Sa i përket pretendimeve në lidhje me aspektet teknike që ndërlidhen me zhvillimin e moduleve lëndes me arsyetimet si në vijim: dhe avancimin e sistemit për 36 muaj, të gjitha sqarimet janë trajtuar me herët dhe janë pjesë e AK- gëzon të drejtën të kërkojë nga OE në afatin përcaktuar në këtë dokument që të krijojë edhe modulet dhe shërbime shtesë pa asnjë kufizim në kosto, apo afat kohor. - Referuar Ofertës së OE-së nuk ofrohet kjo mundësi, OE në fjalë gjatë gjithë kohës ndërlidhet që do të krijojë Sistem të ri, gjë që është në kundërshtim me kërkesën e AK-së dhe nuk mund të pranohet si zgjidhje. Në oferte është specifikuar që AK e gëzon të drejtën të kërkojë nga OE në afatin përcaktuar që të krijojë edhe modulet dhe shërbime shtesë pa asnjë kufizim në kosto, apo afat kohor.

Prioritet 4 - zhvillimi i moduleve të reja jo më vonë se 20 ditë pune. - Sipas Ofertës OE ka ofruar zhvillim vetëm vitin e parë, gjë që është në kundërshtim me kërkesën e AK-së, sipas DT kërkohet që behet Zhvillim gjatë gjithë kohës sipas kërkesës së AK-së, referuar Kërkesës së AK-së kërkohet Avancim dhe mirëmbajtje e sistemit ekzistues pa ndryshuar natyrën dhe metodologjinë që kjo oferte rezulton me ndryshim nga Objektivi i projektit, referuar Ofertës së OE rezulton se të njëjtit ofrojnë që sistemi të

zhvillohet nga Fillimi gjë që është ne kundërshtim te plote mekerkesën e AK-se pasi modulet ekzistuese vetëm janë ne përdorim dhe nga te njëjtët ofrohen shërbime pa ndërprerë, andaj për MSh nuk është kërkuar që të ndryshoi sistemi, kjo ishte eSpecifikuar edhe tek qëllimi i projektit "Mirëmbajta dhe Avancim e zgjidhjes ekzistuese".Referuar Ofertës Teknike OE nder të tjera ka deklaruar se do te ofroj një sistem softuerik... gjë që është ne kundërshtim të plotë me kërkesat e AK-se dhe dëshmon gjatë se OE nuk ka ofertuar për Mirëmbajtjen dhe Avancimin e këtij sistemi mirëpo me qëllimin e krijimit të një Sistemi të Ri, kjo

gjë me detaishtë është e qartësuar ne faqe 48 tek Propozimi Teknik i ofertës se OE.

Referuar ofertës se OE përkatësisht faqe 62 dhe 63 vërehet qartë se OE nuk do të avancoi sistemin siç është përshkruar ne dosje te tenderit, pasi referuar Planit dinamik ne faqe 63, ku potencohet se do te ofroj mirëmbajtje 36 muaj dhe nuk do te ofroj avancim ne zgjidhjen ekzistuese, andaj planidinamik i propozuar dëshmon një gjë të tillë.Bazuar ne sqarimet e lartcekura, pretendimet e juaja ankimore janë te pa bazuara.”

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 24/11/2023 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 898/23, ndërsa me datë 27/11/2023 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2023/0898 me rekomandimet si në vijim: Duke pasur parasysh vendimin e PSH.OSHP nr.0282 te datës 13.09.2023 me që rastë procedura e është kthyer ne rivlerësim dhe ku është kërkuar që të kërkohen sqarime me të detajuara lidhur me dy pretendimet ankimore, bazuar ne ketë është vërejtur se AK nuk ka respektuar ne mënyrën e duhur vendimin e PSH.OSHP dhe Nenin 72 dhe ne bazë të kësaj kërkoj nga PSH.OSHP qe ta kthej prapë procedurën ne rivlerësim dhe të zbatohet vendimi nr.0282 i dt.13.09.2023 dhe Nenin 72 nga ana e AK lidhur me këto dy pretendime.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, “Autoriteti kontraktues nuk pajtohet me raportin e ekspertizës . Ndërsa OE pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues ”

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “Botek” shpk eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 202/0898 ka vlerësuar si në vijim:

Eksperti shqyrtues pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit si dhe shqyrtimit të pretendimeve ankimore të palës në ankesë sqaron si vijon:

Lidhur me pretendimet ankimore të operatorit ekonomik ankues së autoriteti kontraktues MSH-Ministria e Shëndetësisë ka bërë shkëlqen Neneve - Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti - Neni 7 Barazia, Trajtim/ Jo- Diskriminimi dhe Neni 28 Specifikimet teknike. - Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve - Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës - Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit - Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë.

Eksperti shqyrtues, Duke pasur parasysh pretendimet ankimore si dhe bazuar në për çështjen dhe palët e njëjta është nxjerrur një vendim nga PSH.OSHP me datën 13.09.2023 me nr.2023/0282, Eksperti shqyrtues në bazë të Rregullores Nr.01/2020 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, Nenin 16 (Rastet e unifikuar) paragrafi 2 dhe 3 që citohet: Në rastet e përsëritur me pretendimet të njëjta ku objekti i kontestit dhe palët janë të njëjtat për rastet të cilat janë shqyrtuar edhe më parë duhet që të trajtohen si qështje të gjykuara „res juridikat“ në kuptim të Nenit 105 paragrafit 2.16 të LPP-së.

Andaj bazuar në këtë pretendimet e njëjta ankimore (disa nga to) nuk janë trajtuar nga eksperti shqyrtues, pasi që Vendimet e PSH.OSHP nuk mundën të komentohen as interpretohen nga ana e ekspertit, për të cilat është nxjerrur një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0489 i dt:14.07.2023 dhe nga pikëpamja ligjore është rast i gjykuar lidhur me pretendimet tjera,

Eksperti shqyrtues ka trajtuar vetëm pretendimet ankimore të cilat PSH.OSHP në vendimin e dt.13.09.2023 me nr.2023/0282 për të cilat është kërkuar nga AK që gjatë fazës së rivlerësimit të vërtetoj edhe njëherë në mënyrë të detajuar dhe të arsyetuar qoftë edhe nga një palë e tretë në aspektin teknik se a përmbushen këto kritere nga ana e operatorit ekonomik kështu që duke qartësuar situatën në aspektin teknik në mënyrë që të arrihet në një konkludim të qartë të mbështetur në analiza profesionale.

Pretendimi ankimore i cili është shqyrtuar nga ana e ekspertit shqyrtues është lidhur me kërkesat si në vijim: “Kërkesa 1: “Operatori Ekonomik duhet të ketë përvojë në zhvillimin dhe implementimin e të paktën 1 (një) projekti për Health Information System, për të paktën njërin nga nivelet e shëndetësisë”- E ka ofruar listën e kontratave, por asnjëra nga referencat NUK e përmbush kërkesën për (një) projekti për Health Information System, për të paktën njërin nga nivelet e shëndetësisë (Parësor, Sekondar ose Terciar). Referenca e MSH-Banka Botërore për projektin “System platform for HIS information System” ka të bëjë me Sistemin e Fondit të Sigurimeve Shëndetësore dhe nuk ka fare të bëjë me Health Information System.”

Specifikimi teknik i detyrueshem-Ankesi nr.1 (lidhur me planin dinamik)

*Prioritet 1 – jo me vonë se 20 minuta pas lajmrimit nga AK gjatë gjithë kohës së mirëmbajtjes
24/7*

Prioritet 2 – Jo me vonë se 2 dite pune për krijimin e raporteve të reja

Prioritet 3 – jo me vone se 5 dite pune riparimet dhe ndryshimet ne kërkesat funksionale tesistemit

Prioritet 4 – zhvillimi i moduleve të reja jo me vonë se 20 ditë punë.

Ne cilësinë e ekspertit shqyrtues gjatë hulumtimit dhe shqyrtimit të procedurës ne sistemin e e-prokurimit nuk kam par as një kërkesë për sqarim te drejtuar nga ana e AK për operatorin ekonomik lidhur me këto dy pika ashtu si që është kërkuar me anë te vendimit te PSH.OSHP te datës 13.09.2023 me nr.2023/0282 i cili ka theksuar si vijon: “procedurës së rivlerësimit lidhur me këto pika obligohet AK që të vërtetojë edhe njëherë në mënyrë me të detajuar dhe të arsyetuar, qoftë edhe nga një palë e tretë, në aspektin teknik se a përmbushen këto kritere nga ana e OE ankues plotësisht, kështu duke qartësuar situatën në aspektin teknik në mënyrë që të arrihet në një konkludim të qartë të mbështetur në analiza profesionale.PSH konstaton se përgjatë procedurës të rivlerësimit, duke aplikuar nenin 72 të LPP-së, të vërtetojë këto pretendime ankimor duke i konsideruar sqarimet dhe deklarimet e ofruara nga ana e OE ankues”

Neni 72 i LPP paragrafi 1 citon: - Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë qe të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

Gjatë shqyrtimit të lëndës është parë që AK nuk ka respektuar këtë siç duhet vendimin e PSH. OSHP nr.0282 lidhur me këtë pikë si dhe nuk ka respektuar Nenin 72 lidhur me keto dy pika si me lartë, pasi qe nuk ka kërkuar sqarime te detajuara nga ana e Operatorit ekonomik ankues dhe si rezultat i kësaj ne cilësinë e ekspertit shqyrtues nuk mundem qe të konkludoj se i njëjti a i plotëson kërkesa, kriterin apo jo.

Eksperti shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë te obliguara që të zbatojnë vendimet e PSH.OSHP si dhe të sigurojnë qe fondet publike dhe burimet publike te përdorën në mënyrë më ekonomike njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në Nenin 6 te LPP-së, autoriteti kontraktues duhet të ketë ne konsideratë edhe Nenin 1 te LPP-së pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën më efikase, me transparente, jo diskriminuese dhe me te drejtë të shfrytëzimit te fondeve dhe burimeve ne mënyrë të duhur dhe ligjore.

- Konstatimi i Panelit Shqyrtues –

Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesës, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa

parashtrerasat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore. Në këtë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit, sikurse Ankesat në këtë rast.

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtrerasat dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues, duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen e pavarur e tij/sajë, se AK nuk vepruar konform dispozitave të cituara si më sipër, të precizuara dhe të argumentuara ato në ankesë dhe në raportin e ekspertit shqyrtues. Në këtë rast Paneli shpjegon se raporti i ekspertizës i përmban të gjitha pohimet ankimore, por nuk i përmban analizat lidhur me to, duke i shpjeguar në mënyrë specifike në raport me dispozitat e shkelura, sikurse kërkohet kjo së paku me dispozitën e nenit 113 dhe 114 të LPP-së. Raporti i ekspertit shqyrtues nuk prodhon efekte detyruese për asnjërën nga palët dhe as për panelin shqyrtues, prandaj i njëjti (natyrisht dhe vlerat provuese të tij) gjithnjë analizohen në raport me të gjitha shkresat e një lënde, me rrjedhën e procesit të prokurimit, veprimet e palëve, qëllimin dhe natyrën e një aktivitetit të prokurimit, i cili në parim synon përmbushjen e nevojave publike, me përdorimin e fondeve publike, të cilat i janë besuar secilit AK, në cilin do nivel.

Lidhur me këtë aktivitet të prokurimit ka pasur edhe një vendim paraprak të OSHP-së Nr.2023/0282, i datës 13.09.2023, dhe eksperti shqyrtues ka deklaruar se gjatë hulumtimit të tij në shqyrtimin e kësaj lënde në sistemin e e-prokurimit nuk ka gjetur ndonjë sqarime të drejtuar OE. Ky konstatim i ekspertit shqyrtues nuk gjenë mjaftueshëm përkrahje nga ana e panelit sepse në vendimin paraprak të OSHP është obliguar AK jo të kërkohen sqarime vetëm duke aplikuar nenin 72 por, citat: "*gjatë procedurës së ri-vlerësimit lidhur me këto pika obligohet AK që të vërtetoj edhe njëherë në mënyrë më të detajuar dhe të arsytuar, qoftë edhe nga një palë e tretë, në aspektin teknik se a përmbushen këto kritere nga ana e OE ankues plotësisht*". Kështu që, eksperti shqyrtues nuk është marrur fare me trajtimin edhe të vendimit të AK në përgjigje të kërkesës për ri-shqyrtim, vendim ky i cili gjendet në platformën e e-prokurimit i datës 02.11.2023, evidentohet se AK ju është drejtuar edhe Departamentit Ligjor të MSH dhe me dt. 24.10.2023, ku është sqaruar se Fondi i Sigurimeve Shëndetësore nuk i takon njonjërit na nivelet e shëndetësisë, siç është kërkuar në njoftimin për kontratë dhe Dosje të Tenderit. Po ashtu, edhe në letrën standarde për tenderuesit e eliminuar të datës 25.10.2023, evidentohet se AK gjegjësishtë njësia e kërkesës ka kërkuar edhe mendim profesional nga eksperti i Bankës Botërore me çrast i kanë konstatuar dallimet sa i përket sistemeve të aluduara nga ankuesi.

Kështu që, për panelin shqyrtues është në përgjegjësi të AK të përcaktoj palën e tretë në këtë rast ashtu sikurse është edhe në përgjegjësi të AK që vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e ofertave ta bëjë konform nenit 59 të LPP dhe në mungesë të ofertave të përgjegjshme ta anuloj në tërësi aktivitetin e prokurimit. Në kontekstin e shpjegimeve si më sipër paneli konsideron se AK ka përmbushur rekomandimet e dhëna sipas vendimit paraprak të këtij Organi me çrast burimet e konsultuara dhe/ose opinionet e siguruara profesionale nga palët e treta, i japin të drejtë AK që të njëjtat ti karakterizoj me efekt prove të cilat përndryshe kanë ushtruar ndikim në vendimarrje të pavarur të autoritetit kontraktues, pa nevoj që domosdo në këtë rast t[gjej zbatim rekomandii i dhënë në kuptim të nenit 72 të LPP.

Andaj, paneli shqyrtues duke e pasur parasysh rëndësinë e këtij aktiviteti të prokurimit dhe vështirësinë e vendosjes meritore në kontekstin e konstatimit të ndonjë nga OE si të përgjegjshëm dhe me të gjitha këto dyshime dhe kundër argumenteve/provave të paraqitura nga të dy palët në procedurë, erdhi në përfundim se vendosja më e drejtë lidhur me këtë procedurë është anulimi i saj dhe AK në rast se të njëjtën e ka në plan ta ri-tenderoj atëherë të ketë kujdes në vendosjen e kritereve si dhe në rast të ndonjë kërkese e cila nuk është sqaruar mjaftueshëm

atëherë gjitha palët që janë të interesuara të ofertojnë të kërkojnë edhe sqarime shtesë në fazën epara aplikimit në tender.

Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendosë po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës bazuar edhe në nenin 24 paragrafi 2 të LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lartë të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se pohimi ankimor i OE ankues është i papazuar dhe refuzohet, ashtu siç janë dhënë në konstatimet e panelit.

Paneli shqyrtues në këtë vendim marrje ka pasur në konsideratë edhe kërkesat e nenit 104, paragrafi 4 të LPP, sipas të OSHP duhet të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme, të veprojë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - Botek shpk**
- Arkivës së OSHP-së: